

TAKIMI I PARË 2025 - KOMITETI SEKTORIAL I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Mbledhja e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit u mbajt më datë **18.03.2025**.

Takimi filloi me prezantimin e gjetjeve të studimit të UNDP Albania *“Ndikimi i digjitalizimit në sektorët prioritarë të ekonomisë: energji, TIK dhe turizëm”*. Përfaqësuesi i UNDP Albania informoi se, analiza ishte zhvilluar nga dy këndvështrime: vlerësimi teknik i nivelit të digjitalizimit në tre sektorët përkatës dhe analiza e ekspozimit të sektorëve ndaj profesioneve dhe profileve të ndryshme të digjitalizimit.

U bë e ditur se, studimi ishte fokusuar në sektorin e turizmit, energjisë dhe TIK. Të dhënat ishin mbledhur nga 100 kompani, prej të cilave 30% i përkisnin sektorit TIK. Nga këto, 17 kompani operonin në tregun shqiptar, 11 në tregun e huaj dhe 2 kompani në të dy tregjet. Metodologjia e përdorur ishte një metodë e avancuar, e aplikuar nga kompani të mëdha konsulence për vlerësimin e nivelit të digjitalizimit.

Sipas studimit kompanitë u klasifikuan në katër nivele digjitalizimi: niveli i parë - kompani me infrastrukturë digjitale bazë; niveli i dytë - kompani me procese bazike të digjitalizuara dhe komunikim të ndërlidhur; niveli i tretë - kompani me produkte dhe shërbime të ndërlidhura, me elementë të teknologjive të avancuara dhe niveli i katërt - kompani të digjitalizuara në të gjithë elementët e veprimtarisë së tyre.

Rezultatet e studimit treguan se 3% e kompanive nuk arrinin nivelin e parë të digjitalizimit, një kompani ishte në nivelin I, rreth 80% në nivelin II, një kompani në nivelin III dhe një kompani në nivelin IV. U theksua se, sektori TIK kishte nevojë për përmirësim, pasi nuk duhet të kishte kompani që nuk arrijnë nivelin minimal të digjitalizimit.

U evidentua se, kompanitë që operonin në tregun e huaj ndodheshin kryesisht në nivelin II, ndërsa ato që operonin në tregun shqiptar ishin të përfaqësuara në të gjitha nivelet e digjitalizimit.

Përfaqësuesja e UNDP Albania sqaroi se, studimi nuk synonte një përgjithësim kombëtar, por ofronte një analizë të thelluar teknike, e cila shërbente për identifikimin e fushave konkrete ku sektori privat mund të përmirësohej. U theksua gjithashtu, ekspozimi i pamjaftueshëm i profesioneve jo-programuese në tregun shqiptar të punës.

Në përmbledhje të gjetjeve, u theksua se, ekzistonte një bazë e mirë infrastrukturore digjitale, kompanitë ishin të hapura ndaj teknologjive të reja dhe përdorimit të sistemeve të IA, veçanërisht në sektorin e turizmit. Megjithatë, përdorimi i IA për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve

mbetej i kufizuar, ekzistonte nevoja për diversifikimin e profesioneve digjitale dhe rritjen e bashkëpunimit ndërsektorial.

Në vijim, mbledhja u fokusua në diskutimin lidhur me përdorimin e IA në bizneset shqiptare, ku u theksua se, përdorimi i saj ishte më i lartë për procese të brendshme sesa për zhvillimin e produkteve dhe shërbimeve për tregun.

Kryetari i Komitetit informoi anëtarët se inteligjenca artificiale ishte një fushë me rëndësi aktuale dhe kërkonte diskutim mbi kualifikimet përkatëse. Ai sqaroi se IA bazohej kryesisht në “Machine Learning”, i cili mundësonte përpunimin e të dhënave për klasifikim, parashikim dhe gjenerim përmbajtjeje, duke theksuar rrezikun e pasaktësive.

Gjatë diskutimit u klasifikuan fushat kryesore të IA, duke përfshirë: “Introduction to Machine Learning”, “Data Mining”, “Process Mining”, “Computer Vision”, “Large Language Models”, “Advanced Deep Learning” dhe “Audio Processing”, si dhe u dhanë disa shembuj praktikë përdorimi. Anëtarët diskutuan mbi nevojën për orientimin e kualifikimeve drejt formimit të prodhuesve të IA dhe jo vetëm përdoruesve. U theksua rëndësia e referimit në praktikat dhe zhvillimet europiane.

Përfaqësues të AKAFPK-së informuan se, IA ishte parashikuar të integrohej në të gjitha kualifikimet ekzistuese të TIK, por u vlerësua e nevojshme përcaktimi i niveleve dhe i kornizës së aftësive. U përmend gjithashtu potenciali i sektorit të turizmit si fushë pilot për aplikime më të avancuara digjitale.

Në përfundim të takimit u prezantua standardi i kualifikimit profesional ***“Mbështetje për përdorimin e sistemeve TIK”***, i cili ishte hartuar mbi bazën e standardit të profesionit të validuar më parë nga Komiteti. U prezantuan njësitet e të nxënësve dhe peshat specifike në % për secilën prej tyre. Anëtarët propozuan ndryshime të vogla në % e peshave të njësive të të nxënësve që ishin teknike, të cilat u reflektuan në draft-in final. Standardi i kualifikimit profesional u validua pa ndryshime përmbajtëse.

➤ **Vendime të marra nga mbledhja:**

- U validua standardi i kualifikimit profesional: ***“Mbështetje për përdorimin e sistemeve TIK”***, niveli V në KSHK.